



Informacione në lidhje me kërkesën për ndihmë sociale

Ju lutemi, vini re ndryshimet e mëposhtme:

Në bazë të vendimit të Këshillit Federal “gjendja e jashtëzakonshme” u pezullua sërish prej datës 19 qershor 2020. Kalimi në "situatë të veçantë" shoqërohet me masa të ndryshme lehtësuese që synojnë të mundësojnë kthimin gradual në normalitet. Udhëzimet e dhëna nga Zyra Federale e Shëndetit Publik dhe nga Këshilli qeveritar i Kantonit të Bazelit dhe masat paraprake të ndërmarra për të shmangur efektet e dëmshme shëndetësore për ju dhe për punonjësit e shërbimit social vazhdojnë të mbesin në fuqi. Ndihma sociale duhet të vazhdojë të sigurojë respektimin e rregullave të higjienës dhe të distancës për t'i mbrojtur të gjithë të përfshirët. Kufizimet dhe udhëzimet e mëparshme që kanë të bëjnë me zbatimin tanimë të diskutuar mund të lehtësohen me kalimin në "situatë të veçantë", por jo edhe të hiqen plotësisht.

Informacione të përgjithshme për procesin e pranimit mund të merren në numrin e mëposhtëm të telefonit:

061 / 267 02 22

Nëse keni ndonjë pyetje specifike që ka të bëjë me mbështetjen financiare, punëtorët tanë të qendrës telefonike do ta përcjellin kërkesën tuaj në një linjë të re të krijuar **drejtpërdrejtë telefonike** (Hotline). Një punëtore ose një punëtor me përvojë i ndihmës sociale do t'ju marrë në telefon dhe me ju do t'i diskutojë pyetjet dhe do t'ju tregojë për hapat e mëtejshëm. Me këtë rast do të dëshironim në mënyrë të veçantë t'ju referojmë në **kalkulatorin tonë të përfitimeve sociale**, me të cilin mund të bëni vetë një llogaritje të kërkesës së parë.

Ju lutemi të mos paraqiteni personalisht, por kërkesën tuaj për ndihmë ta paraqisni nëpërmjet **telefonit, me shkrim me postë ose me email** (sozialhilfe.neuaufnahme@bs.ch). Stafi i ndihmës sociale do t'ju kontaktojë.

Për ta bërë më të lehtë procesin e aplikimit, kemi përmbledhur pyetjet dhe përgjigjet më të rëndësishme në tabelën e mëposhtme:

Pyetja	Përgjigja
A kam të drejtë në mbështetjet që ofron Ndihma Sociale e qytetit të Bazelit?	<ul style="list-style-type: none">• Për sqarime paraprake i referohemi llogaritësit të ndihmave sociale.• Nëse keni ndonjë pyetje që ka të bëjë me mbështetjen ose regjistrimin, ju lutemi informohuni në këtë numër të telefonit 061 / 267 02 22• Kërkesat tuaja do të regjistrohen. Ne do t'ju kontaktojmë.
Unë dua të aplikoj. Çfarë duhet të bëj?	<ul style="list-style-type: none">• Aktualisht aplikimet pranohen me shkrim. Ju lutemi dërgoni dokumentet tuaja:<ul style="list-style-type: none">➤ me Mail në: sozialhilfe.neuaufnahme@bs.ch ose➤ me postë në: Sozialhilfe Basel-Stadt, Postfach 4067, 4001 Basel ose➤ hidheni ato drejtpërdrejt në një nga kutitë postare të Sozialhilfe Basel-Stadt në Klybeckstrasse 15, 4057 Basel. <p>Të gjitha dokumentet e kërkuara për aplikim mund t'i gjeni në faqen tonë të internetit Sozialhilfe/Neuaufnahme.</p>

<p>Cilat dokumente i duhen ndihmës sociale?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Për trajtimin e kërkesës suaj na duhen: <ul style="list-style-type: none"> ➤ kërkesa për mbështetje e plotësuar plotësisht dhe e nënshkruar ➤ fletë-informacioni për kërkesën për mbështetje i nënshkruar dhe ➤ fletë-pyetëtori i plotësuar i BfS-së. • Medoemos duhet t'i bashkëngjitni edhe këto dokumente si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kopja e letërnjoftimit ose e lejë-qëndrimit. ➤ Kopja e kontratës së qirasë. ➤ Kopja e polisës së sigurimit shëndetësor dhe fletëpagesa aktuale. ➤ Dëftesat e llogarive të të gjitha llogarive për dy muajt e fundit dhe gjendja aktuale e llogarisë rrjedhëse. ➤ Dokumentet relevante të të ardhurave dhe të pasurive, nëse i posedoni. ➤ Ju lutemi vini re listën tonë të kontrollit. <p>Ju lutemi keni kujdes , që ne pa këto dokumente kërkesën e juaj nuk e shqyrtojm, ashtu që të drejtën e juaj për ndihmë sociale nuk mundemi t'a qartësojm.</p>
<p>Si funksion aplikimi?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Pas pranimit të aplikacionit tuaj me shkrim, ndihma sociale do t'ju kontaktojë. Nëse është e nevojshme do t'ju ftojme në një bisedë personale. • Nëse dokumentacioni i juaj është komplet, atëherë punëtorja ose punëtori i ndihmës sociale do t'ju kontaktojë me telefon ose do t'ju ftojë për bisedë për t'i sqaruar pyetjet dhe hapat e mëtejshëm. • Nëse mungojnë nënshkrimet tuaja, atëherë do të caktojmë takim me ju. <p><u>Ju lutemi të keni kujdesë që t'i nënshkruani të gjitha dokumentet në vendin e paraparë për nënshkrim.</u></p>

Këshilla dhe biseda informuese	<ul style="list-style-type: none">• Ju lutemi të na kontaktoni me telefon ose me email. Bisedat personale do të zhvillohen vetëm kur caktohet takim paraprakisht.• Hyrja në objektet e ndihmës sociale mund të bëhet vetëm me një ftesë përkatëse (letër, SMS, email).
--------------------------------	---

Ju falënderojmë për mirëkuptimin. Mbeteshit të shëndetshëm!